


Tiranë, më 22 Shkurt 2016

KËRKESË PENALE



Drejtuar:

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

I dëmtuar akuzues:

Iilir BEQAJ, i biri i Hamitit, i lindur më 1968, Ministër i Shëndetësisë, Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë.

I akuzuar:

Lulzim BASHA, i lindur më 12.06.1974, në Tiranë, banues në Tiranë, në adresë Bulevardi "Zhan D'Ark 11", 1000 Tiranë.

Objekti i Kërkesës:

Gjykimi dhe dënimi i të akuzuarit Lulzim Basha, për kryerjen e veprave penale të:

- Fyerjes, së kryer botërisht, në bazë të nenit 119/2 të Kodit Penal.
- Shpifjes, së kryer botërisht, e parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal.

Baza ligjore:

Nenet 59 dhe 60 të Kodit të Procedurës Penale.

I/E Nderuar Z/znj Gjyqtar/e!

Nënshkruesi i kërkesës, synon nëpërmjet shqyrtimit të saj dhe vendimit Tuaj të drejtë, mbrotjen e dinjitetit dhe personalitetit të cënuar për shkak të veprimeve penalisht të ndëshkueshme të të akuzuarit Lulzim BASHA. Ky i fundit, tej lirisë së shprehjes dhe veprimtarisë së tij politike, ka agresuar verbalisht e në disa raste, të dëmtuarin, duke konsumuar njëkohësisht të dy veprat e renditura në krye të kërkesës, përkatësisht fyerjen dhe shpifjen, realizuar këto akte botërisht.

I. NË LIDHJE ME FAKTET

Ilir BEQAJ, është person fizik, prej afro tre vitesh në detyrën e Ministrit të Shëndetësisë dhe në këtë çështje ka cilësinë e të dëmtuarit akuzues nga veprat penale të kryera nga i akuzuari.

Lulzim BASHA, është shtetas shqiptar, në moshë madhore, pa kufizime apo privilegje imunitare në lidhje me përgjegjësinë penale, banues në Tiranë. Në këtë kallëzim është akuzuar në cilësinë e personit fizik.

Në datën 17 Nëntor 2015, gjatë fjalës së mbajtur në një konferencë për shtyp, pas takimit me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në oborrin e godiën ku ka selinë aktualisht Partia Demokratike, si dhe në prani të shumë gazetarëve e kamerave televizive të stacioneve të ndryshme ndër të tjera është shprehur:

“Nuk ka kryeministër në Europë si kryeministri shqiptar i cili pasi konfrontohet nga të dhëna të pakundërshtueshme të “hajdutërisë së

ministrave të tij, të BEQAJ, llogaria e të cilit ka shkuar 31 milionë euro tendera....."

Atë ditë në mediat elektronike, si dhe të nesërmen datë 18 Nëntor 2015, deklarata e plotë, përfshirë pjesën relevante me këtë kërkesë e të cituar më lart, është përcjellë në thuajse të gjitha mediat e shkruara në vend.

Pohimet verbale të sipërcituara përmbajnë të dhëna të rreme mbi personin Ilir BEQAJ dhe janë konsumuar publikisht pa asnjë lidhje logjike me pyetjet konkrete të gazetarëve të pranishëm si dhe vetë objektin apo qëllimin e përballjes mes të akuzuarit Lulzim BASHA dhe gazetarëve. Njëkohësisht këto pohime përbëjnë cënim të dinjitetit dhe personalitetit të shtetasit Ilir BEQAJ dhe pavarësisht vazhdimësisë së mëtejshme, përzgjidhen ekskluzivisht si trup krimi të pretenduar të konsumuar tashmë plotësisht nga shtetasi Lulzim BASHA në dëm të kërkuarit.

II. VEPRAT PENALE OBJEKT I KËRKESËS.

Nga ana e shtetasit të akuzuar, janë kryer veprime të kundërligjshme, duke u konsumuar elementët e figurës të veprave penale që vijojnë:

a. Fyerja:

"Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë.

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë." (Neni 119 i Kodit Penal).

Konkretisht në pohimet e përzgjedhura të zotit BASHA, përbën fyerje shprehja verbale "hajdutëri e ministrave si BEQAJ"!

Konsiderimi *hajdut*, përveçse shkeljes etike të folësit publik të akuzuar, përbën pavërtetësi e gënjeshtër të qëllimtë të konsumuar për çfarëdo përfitimi të paligjshëm e të padrejtë prej tij.

b. Shpifja:

“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se është të rreme, që cenon nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë.

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.” (Neni 120 i Kodit Penal)

Konkretisht, përbën shpifje të kryer botërisht, pjesa e ligjërimit publik të zotit BASHA, ku ky i fundit pretendon që llogaria e zotit BEQAJ, për shkak të tenderave ka shkuar 31 milion euro!!!

E ndërlidhur gjithësesi në përmbatje dhe formë me elementë të fyerjes, në thelbin e vetë fjalia e përzgjedhur përbën konsumim absolut të veprës të parashikuar nga neni 120, paragrafi 2, i Kodit Penal.

III. MOTIVIMI LIGJOR DHE MORAL I KËRKESËS PENALE.

Sikurse pohuar më lart, shtetasi i akuzuar, me dashje, me veprime konkrete, nëpërmjet deklarimeve publike, ka konsumuar të plota veprat penale objekt i kësaj kërkesë.

Qëllimi i kundërligjshëm, në kryerjen e veprave penale të fyerjes dhe të shpifjes botërisht, ka rezultuar i qartë, i provuar nga provat e bëra publike dhe të bashkëlidhura këtij kallëzimi.

Veprimtaria e kundërligjshme e përshkruar, e konsumuar nga subjekti i akuzuar është konsumuar përgjatë reagimit publik të të akuzuarit nëpër media të ndryshme dhe është pasqyruar në shtypin e nesërm.

Kundërligjshmëria e veprimeve dhe konkretisht e shprehjeve verbale të të akuzuarit, përcaktohet si e tillë në mënyrë hierarkike nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane "Për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të Njeriut", si dhe i normat konkrete të Kodit Penal mbi fyerjen dhe shpifjen.

Pasojat e ardhura nga ky akt janë cënimi i dinjitetit të të dëmtuarit akuzues, i personalitetit të tij dhe integritetit moral. Njëkohësisht, së mos korrigjuari e ndëshkuari, i akuzuari vijon të përsërisë aksionin e tij të paligjshëm.

Faktet e parashtruara në kërkesën penale përmbushin të gjithë elementët e figurave të veprave penale objekt i kërkesës penale, të parashikuar nga nenet 119/2, 120/2 të Kodit Penal.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në § 2, të Nenit 10 (Liria e shprehjes) kufizon mundësitë, për sjelljet e qytetarëve të Shqipërisë, njëkohësisht edhe politikanë, duke siguruar kundërveprime të ligjit për shkeljet:

"Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji, të cilat në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme për... ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informacioneve konfidenciale..."

Veprat penale objekt i kërkesës penale janë të hapura dhe, nuk kërkojnë analiza të hollësishme të elementëve të figurës së veprës penale, për shkak të rëndësisë së faktit dhe të subjektit të posaçëm. Në rrethanat e faktit, ekzistenca e të cilave nuk mund të mohohet, gjenden të konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale, të pasojës dhe të lidhjes shkakësore, për rrjedhojë, të fajësisë individuale të të akuzuarit Lulzim Basha.

Subjekt i veprave penale në këtë kasus, është Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Cilësitë si subjekt i posaçëm, nuk e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale, për vepra të kryera kundër kujtdo shtetasi.

Subjekti për të cilin kërkohet gjykimi penal nuk ka shkaqe apo arsye ligjore, që të mundësojnë përjashtimin e tij nga përgjegjësia penale. Është madhor dhe i përgjegjshëm përpara ligjit.

Ana objektive e figurës së veprës e penale përmbahet nga veprimet konkrete të subjektit të akuzuar. Pa asnjë lloj ngacmimi të jashtëm, të çastit apo të qëndrueshëm, nga i dëmtuari apo të tretët, në tejkalim të dukshëm të pyetjes së drejtuar, subjekti i akuzuar i është drejtuar opinionit publik, me ndërjegje të plotë, duke treguar të dhëna të pavërteta, të rreme, të krijuara prej tij.

Rrethanat e kryerjes së veprës penale, mënyra e kryerjes së saj, mungesa e lidhjes logjike midis pyetjeve dhe përgjigjes me përmbajtje fyese dhe shpifëse, zbulojnë dashjen direkte të subjektit të akuzuar në arritjen e qëllimit të kundërligjshëm.

I vetmi synim i subjektit të akuzuar dhe i veprimeve të kryera prej tij (përmbajtja e deklarimeve publike) ishte nëpërkëmbja, cënimi i dinjitetit dhe personalitetit të të dëmtuarit.



Ana subjektive në kundërligjshmërinë e fyerjes dhe shpifjes, dashja si formë konkrete faji gjendet e provuar, për sa kohë konsumimi verbal është veçse shprehje e vullnetit të subjektit, për të përhapur shprehje të pavërteta dhe fyese. I ndërgjegjësuar subjekti i veprës, që thëniet e tij sjellin efekte negative tek "i dëmtuari", bëhet mbartës ekskluziv i figurave të krimit që i atribuohen në këtë kërkesë.

Veprat e kryera nga i akuzuari janë veçanërisht të rrezikshme, sepse janë kryer publikisht nëpërmjet mjeteve të komunikimit me publikun, si forma të fyerjes dhe shpifjes të kryera botërisht.

Rrezikshmëria e veçantë e shpifjes qëndron kryesisht në elementin e anës subjektive, pasi thëniet dihet që janë të rreme. Duke qenë se përmbajtja e këtyre thënieve ka natyrë faktike ato, krijojnë bindje të opinionit shoqëror për zhvlerësimin e dinjitetit të personit, sepse mbështeten në "fakte" të servitura si të vërteta.

Në mbrojtje të të dëmtuarit është jo vetëm ligji material, por dhe jurisprudenca vendase, si dhe praktika e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut. Në të paktën 5 (pesë) raste autoritare mbi këtë kazus Gjykata e Strazburgut disiplinon pozitivisht si më poshtë:

- a. Në çështjen "Cordova kundër Italisë" - 2003, gjykata ka konstatuar se:
"...komentet e bëra jashtë parlamentit, dhënia e imunitetit parlamentar këtyre deklarimeve përbën një ndërhyrje jo proporcionale me nenin 6 të konventës."
- b. Gjithashtu, në çështjen "A. kundër Britanisë së Madhe" gjykata ka diferencuar ndërmjet imunitetit që i jepet deklaratave të bëra gjatë zhvillimit të debateve parlamentare, me qëllim mbrojtjen e interesave

të parlamentit në tërësi dhe, të deklaratave të parlamentarëve si individ:

“Më tej, gjykata thekson se nuk ka imunitet për deklarata të bëra jashtë parlamentit apo në një konferencë për shtyp ndaj një deputeti edhe pse përmbajtja e tyre mund të përsërisë deklarata të bëra në debatin parlamentar.”

- c. Me vendimin e datës 22.02.2002, midis “Dichand etj kundër Austrisë”, GjEDNj, ka bërë një dallim ndërmjet gjykimeve vlerësuese dhe fakteve (konstatimit apo parashtrimit të fakteve). Gjykata orienton se, në parim, gjykimet vlerësuese nuk mund të provohen. Gjykata vijon, duke nënvizuar se: *“kjo nuk do të thotë që i padituri, mund të shprehë çdo opinion, pavarësisht se sa dëmtues mund të jetë ai, pa pasur prova për ti mbështetur ato”*. Në këtë kuptim, gjykata ka vlerësuar që edhe gjykimet vlerësuese kërkojnë një bazë faktike.
- d. Me vendimin datë 07.05.2002 (“McVicar kundër Britanisë së Madhe”, Nr.46311/99, paragrafi 87), GjEDNj hapur, qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, krijon jurisprudencë evropiane, duke kërkuar përsa i përket konstatimeve të fakteve që i kundërvihen të drejtave dhe dinjitetit të individëve të tjerë, *“i akuzuari/i paditurit për shpifje, të provojë të vërtetën e deklaratave faktike që ka bërë”*.
- e. Në vendimin e datës 17 dhjetor 2004, në gjykimin e kërkesës “Pedersen dhe Baadsgard kundër Danimarkës”, Dhoma e Madhe e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut e kufizon të drejtën e gazetarit vetëm në dhënien e gjykimeve vlerësuese, duke konsideruar cënim të të drejtës së tjetrit prezantimin e deklaratave faktike, të rreme apo të pavërtetuara.

IV. NË LIDHJE ME PROVAT.

Veprimtaria e kundërligjshme objekt i kërkesës penale provohet me një tërësi provash materiale dhe shkresore, nga të cilat veçojmë duke ja paraqitur gjykatës:

1. Regjistrim me zë dhe figurë i tërësisë së komunikimit të të akuzuarit BASHA, me gazetarët më datë 17 Nëntor 2015.

Objekti ku ruhet regjistrimi është një disk kompakt siç është përcjellë nga televizioni publik shqiptar me shkresë të posaçme, pas kërkesës sonë e kundrejtë detyrimeve ligjore.

2. Kopje autentike të disa gazetave të përditshme shqiptare, ku pasqyrohet i njëjti komunikim me mediat i zotit BASHA.

Gazetat janë në stampime elektronike autentike nga faqet përkatëse, si dhe ekzemplarë në origjinal të tyre.

V. KËRKIME PËRFUNDIMTARE DHE INFO MBI CURRICULUMIN GJYQËSOR TË RASTIT.

Kërkesa për gjykimin dhe dënimin e zotit BASHA, dorëzohet për së dyti pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Penal, dhoma penale, pasi gjyqtari i ngarkuar me shqyrtimin fillestar të saj, vendosi pushimin e gjykimit për shkak të mos paraqitjes sime apo mbrojtësit, në seancën e datës 17.02.2016.

Pavaresisht faktit që në përballjet me palën tjetër e të njëjtin gjyqtar, në asnjë rast nuk u shfaq si i zbehur apo i munguar, interesi ynë për zhvillimin e përfundimin pozitiv të këtij rasti, pushimi u

“justifikua” nga një vonesë 60 sekondëshe paraqitjeje në sallë, duke përbërë një rekord “korrektësie” jo vetëm për këtë gjyqtar të pashquar, po për gjithë gjyqësorin shqiptar në tërësi!!!

Në rrethana të tilla, detyrohem të rikërkoj gjykimin dhe dënimin penal kundër shtetasit Lulzim Basha, autor i veprave penale të cituara, madhor, i përgjegjshëm para ligjit, banues në Tiranë, për kryerjen e veprave penale të fyerjes dhe të shpifjes, të kryera botërisht.

**Me konsideratë
I dëmtuari akuzues
Ilir BEQAJ**

